

VENDIM
Nr.1415, datë 22.10.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE QENDRA SPITALORE
UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, të përfundojnë procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 8 dhjetor 2008. Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
PROCEDURAT QË ZHVILLOHEN NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË

1. Blerje aparaturash laboratorike për disa D.H.E në rrethe dhe pajisje frigoriferike për shërbimin e morgut në disa spitale, me fond limit 22 500 000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë, pa TVSH.

2. Projektpreventiv zbatimi për ndërtimin e godinës të sëmundjeve akute-spitali Shkodër, me fond limit 1 333 334 lekë, pa TVSH.

3. Zgjerimi i infrastrukturës së komunikimit të rrjetit të Ministrisë së Shëndetësisë, me fondin limit 99 500 000 lekë, pa TVSH.

4. Instalimi, personalizimi i *soft-ware* dhe trajnimi i personelit të spitaleve rajonale dhe terciare, me fond limit 25 000 000 lekë, pa TVSH.

5. Shtrirja e shërbimit të hemodializës në sektorin spitalor privat.
Ministria po punon për nxjerrjen e një fondi prej 40 000 000 lekësh, i cili do të shërbejë për kryerjen e shërbimit të hemodializës në klinika private të specializuara.

6. Blerje aparaturash grafi-skopi, me fond limit 83 333 300 lekë, pa TVSH.

7. Furnizimi i institucioneve shëndetësore me materiale konsumi për laboratorë, me një fond limit 82 299 000 lekë, pa TVSH.

Procedura prokurimi që do të zhvillohen nga QSUT “Nënë Tereza” Tiranë

1. “Citostatike”, me fond limit 47 214 000 lekë;

2. “Kontraste” (1 lot kontrast jodik jonik për skaner dhe angiografi), me fond limit 14 000 000 lekë;

3. “Materiale mjekësore për kirurgjinë vaskulare”, me fond limit 5 306 780 lekë;

4. “Medikamente për kirurgjinë vaskulare”, me fond limit 5 632 000 lekë;

5. “Kite dhe reagentë”, me fond limit 60 000 000 lekë;

6. “Materiale për kardiokirurgjinë”, me fondin limit 6 289 000 lekë;

7. “Materiale mjekësore për neurokirurgjinë”, me fond limit 29 999 969 lekë;

8. Sigurimi, normalizimi dhe kontrolli i lëvizjes së pagesave të automjeteve të personelit që hyjnë në Qendrën Spitalore “Nënë Tereza”, me fond limit 2 083 333 lekë, pa TVSH;

9. Blerje aparaturash elektromjekësore për shërbimin e neurokirurgjisë QSUT “Nënë Tereza”,

me fondin limit 21 666 667 lekë;

10. Blerje pajisjesh hotelerie për spitalin e rikonstruktuar pediatrik, me fond limit 5 600 000 lekë.